



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian.
Mbledhja nr. 29.
Prishtinë, më 04.05.2022, në orën 11:00.
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Arbëreshë Kryeziu Hyseni, Fridon Lala, Agon Batusha, Fjolla Ujkani, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Elmi Reçica dhe Time Kadriaj.

Munguan: Blerta Deliu Kodra dhe Branisllav Nikoliq.

Staffit mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

Pjesëmarrës të tjerë: KDI, asistent të grupeve parlamentare të LVV, PDK dhe LDK, si dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi **Rrezarta Krasniqi**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-010 për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-027 për mbeturinat nga industritë nxjerrëse të mineraleve, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-033 për provimin e jurisprudencës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-074 për turizmin, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-010 për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, pasi që paraqiti projektligjin i cili përbëhej nga 25 nene dhe 23 amendamente nga Komisioni funksional, konstatoi se ky projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Integrim Evropian me **6** (gjashtë) vota “për” dhe asnjë votë “kundër”, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Projektligji nr. 08/L-010 për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-027 për mbeturinat nga industritë nxjerrëse të mineraleve, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, pasi paraqiti projektligjin i cili përbëhej nga 33 nene dhe 48 amendamente nga Komisioni funksional, konstatoi se ky projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Komisioni për Integrim Evropian, me 6 (gjashtë) vota “për” dhe asnjë votë “kundër”, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Projektligji nr.08/L-027 për mbeturinat nga industritë nxjerrëse të mineraleve, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-033 për provimin e jurisprudencës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, pasi paraqiti projektligjin i cili përbëhej nga 31 nene dhe 16 amendamente nga Komisioni funksional, tha se, ky projektligj nuk është i rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, sepse kjo mbetet kompetencë e rregullimit të brendshëm të shteteve anëtare të BE-së. Andaj, konstatoi se ky projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit

funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Komisioni me 6 (gjashtë) vota “për” dhe asnjë votë “kundër”, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Projektligji nr.08/L-033 për provimin e jurisprudencës, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, paraqiti projektligjin i cili përbëhej nga 24 nene dhe 14 amendamente nga Komisioni funksional, tha se, ky projektligj nuk është i rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, sepse kjo mbetet kompetencë e rregullimit të brendshëm të shteteve anëtare të BE-së. Projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, tha se nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Komisioni me 6 (gjashtë) vota “për” dhe asnjë votë “kundër”, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Projektligji nr.08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-074 për turizmin, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, paraqiti projektligjin i cili përbëhej nga 52 nene dhe 17 amendamente nga Komisioni funksional, konstatoj se ky projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Komisioni me 6 (gjashtë) vota “për” dhe asnjë votë “kundër”, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Projektligji nr.08/L-074 për turizmin, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

7. Të ndryshme.

Elmi Reçica, paraqiti qëndrimin e opozitës dhe prezencën e tyre në mbledhjen e komisionit, të cilët nuk mori pjesë në asnjë votim për shkak të mosformimit të Komisionit hetimor parlamentar nga Kuvendi i Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

Rrezarta Krasniqi,

Kryetare e Komisionit

*E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit*